

eppc kërkon një *Specialist Shitjesh* për klientin e saj, i cili është një ndër kompanitë më të suksesshme në treg në fushën e marketingut.

Përgjegjësitë Kryesore:

1. Prezantimi dhe promovimi i produkteve tek klientët;
2. Analizimi i plotë i produkteve dhe rekomandimet e duhura tek klientët, me qëllim plotësimin në mënyrë efikase të nevojave dhe kërkesave të tyre;
3. Ndjekja me kujdes dhe përpikmëri e klientëve ekzistues si dhe identifikimi dhe rekrutimi i klientëve të rinj;
4. Negocimi me klientët për realizimin e procesit të shitjes;
5. Bashkëpunimi me strukturat e tjera të kompanisë për realizimin final të porosive;
6. Zhvillimi dhe zbatimi i planit të punës në funksion të planit të biznesit dhe objektivave të kompanisë.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare;
- Përvojë në menaxhimin e shitjeve dhe marrëdhënieve me klientin jo më pak se 2 vjet (*Eksperienca në Agjensi Marketingu përbën avantazh*);
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, negocimi dhe shitjeje;
- Njohje shumë të mirë të gjuhës angleze, e preferueshme dhe gjuha greke;
- Të ketë iniciativë dhe të orientohet drejt rezultateve;
- Të performojë nën stres dhe brenda afateve;
- Të jetë ambicioz, fleksibël, entuziast dhe konfident;
- Njohuri të paketës MS Office, e preferueshme Alpha;
- Të zotërojë patentë të klasit B.

Të dhënat:

Pozicioni:	Specialist Shitjesh;
Vendndodhja:	Autostradë;
Orari:	48 orë në javë;
Raporton:	Drejtori i Përgjithshëm;
Udhëtime pune	Po, por jo intensive;
Pagesa:	Shumë e mirë (fikse + bonuse);
Aplikimet mbyllen:	17 Tetor 2013.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{it}:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.

Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.